



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit



MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë më 15.02.2017

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 15.02.2017, shqyrtoi çështjet si më poshtë:

- Fillimin e procedurave për miratimin e Kontratës tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal.
- Mbi miratimin e Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë ndërmjet shoqërisë OST sh.a dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike.
- Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike.
- Miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE nr.169 datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE nr 103 datë 23.06.2016 , “mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.
- Në lidhje me fillimin e procedurave për miratimin e Kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë.
- Në lidhje me fillimin e procedurave për miratimin e Programit të Përputhshmërisë Rregullatore.
- Për modifikimin e licensës së shoqërisë “Komp.Energji” shpk, me Nr. 248, seria PV14K, miratuar me Vendimin e Bordit nr.94, datë 06.10.2014, për Prodhimin të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”.
- Për modifikimin e licencës së shoqërisë “Komp.Energji” shpk, me Nr. 253, seria T14P, miratuar me Vendimin e Bordit nr.102, datë 07.11.2014, për Tregtim të Energjisë Elektrike.
- Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike , që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2017.